



Nr. 3054/ prot.

6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, më 15.12.2023

VENDIM

Nr. 43 datë 15.12.2023

**"PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT PËR
GJUHË TË HUAJ ANGLISHT ME PROFIL MINOR NË GJUHË SHQIPE, NË
PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NE MËSUESI PËR GJUHË TË
HUAJ,GJUHË ANGLEZE NË DEPARTAMENTIN E METODOLOGJIVE TË
MËSIMDHËNIES NË FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT"**

Bazuar në Ligjin. Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, germa "b"; nenin 35, pika 9, neni 38, pika 1, germa "dh" në Urdhrin nr. 225, datë 07.05.2018 të Ministrit të arsimit "Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë", në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për dokumentacionin dhe procedurat dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL", Kreu IV si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit riorganizimin e programit të studimit Master profesional në "Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për gjuhë të huaj anglisht me profil minor në gjuhë shqipe" në programin e studimit Master i shkencave në "Mësuesi për Gjuhë të huaj, Gjuhë angleze".
2. Diploma ekzistuese Master profesional në "Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për gjuhë të huaj anglisht me profil minor në gjuhë shqipe" të bëhet **Master i shkencave në "Mësuesi për Gjuhë të huaj, Gjuhë angleze"**
3. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në Mësuesi për "Gjuhë të huaj, gjuhë Angleze" (modeli bashkëngjitur).
4. Ky vendim t'i përcillet, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedura të mëtejshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI

